



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr.308/4 prot.

Tiranë, më 07.04.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 30, datë 07.04.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA NGA ORGANET E
NGARKUARA NGA LIGJI GJATË PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR
VLERËSIMIN E PJESSHËM TË REZULTATEVE NË PUNË, NË
INSTITUCIONIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE PARALAJMËRIMIN E
INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR LIGJSHMËRINË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera nga organet e ngarkuara nga ligji gjatë procedurës së ndjekur për vlerësimin e pjesshëm të rezultateve në punë, për nëpunësen Matilda Hoxha, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 308 prot., datë 12.02.2026, të dërguar nga nëpunësja Matilda Hoxha, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë, është njohur me pretendimet e nëpunëses, për parregullsi të kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procedurës së ndjekur për vlerësimin e pjesshëm të rezultateve në punë, për periudhën 26.11.2025 deri në datën 31.12.2025, për këtë nëpunëse.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësja parashtron se, në vlerësimin e pjesshëm për periudhën 26.11.2025 deri në datën 31.12.2025, është vlerësuar me nivelin 4 “Jo kënaqshëm”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të vendimit nr.109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, të ndryshuar, pasi ky vlerësim nuk është objektiv, si dhe i mbështetur në prova dhe fakte.

Më tej, nëpunësja në fjalë duke mos qenë dakord me rezultatin e vlerësimit të pjesshëm, mbështetur në pikën 1, të kreut V, të vendimit nr. 109 datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, në datën 15.01.2026, ka kërkuar kryerjen e rivlerësimit nga Zyrtari autorizues.

Në vijim, Zyrtari autorizues ka kryer procesin e rivlerësimit, duke ruajtur të njëjtin vlerësim përfundimtar me nivelin 4 “Jo kënaqshëm”, njoftuar nëpunëses në datën 15.01.2026. Nëpunësja është shprehur se, nuk është dakord me rivlerësimin, fakt të cilin e ka pasqyruar në plotësimin e pikës 2, të nëndarjes “DH”, të formularit të vlerësimit.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja Matilda Hoxha, filloi procesin e verifikimit të informacionit, nëpërmjet shkresës nr. 308/1 prot., datë 20.02.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje verifikimin e informacionit të dërguar pranë Komisionerit me shkresën nr. 308 prot., datë 12.02.2026”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure vlerësimi, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 1186/1 prot., datë 02.03.2026, me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për dokumentacion”, e protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 308/2 prot., datë 05.03.2026, ka dërguar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton se, me aktin e emërimit nr. 4060/1 prot., datë 12.06.2018, të njësisë përgjegjëse, DAP, nëpunësja Matilda Hoxha, është emëruar në pozicionin e punës “Specialist”, në Sektorin Rregullimit të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Liçensave dhe Monitorimit, në

Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, (*pozicioni jo aktual*).

Referuar këtij dokumentacioni, konstatohet se, për nëpunësen M. Hoxha, janë bërë dy vlerësime të pjesshme për periudhën Korrik-Dhjetor 2025, konkretisht të ndara: për periudhën 01.07.2021-25.11.2025, vlerësuar me nivelin **3**, “*Kënaqshëm*” dhe për periudhën 23.11.2025-31.12.2025, vlerësuar me nivelin **4**, “*Jo kënaqshëm*”, për shkak të ndryshimit të Zyrtarit autorizues, gjatë periudhës së vlerësimit të nëpunëses.

Në bazë të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, që ka dalë në zbatim të kësaj dispozite, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik dhe duhet të respektohen të gjitha fazat e tij, ashtu si parashikohen në pikën 12, kreu II, i aktit nënligjor në fjalë:

- Planifikimi, është momenti kur Zyrtari Raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
- Bisedimet e ndërmjetme, zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku Zyrtari Raportues takohet me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e kryer në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të evidentuar përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.
- Vlerësimi përfundimtar, është një proces që ka të bëjë me vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, duke respektuar afatet e vlerësimit.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar gjatë të hetimit administrativ, rezulton se procedura e mësipërme nuk është respektuar nga Zyrtari Raportues. Në rastin konkret, nuk rezulton të ketë ndonjë dokumentacion që materializon zhvillimin e fazave në të cilat kalon procedura e vlerësimit të rezultateve në punë.

Gjithashtu, konstatohet se, nga ana e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit janë hartuar dy formularë të pjesshëm të vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësen M. Hoxha, për periudhën 01.07.2021-25.11.2025 dhe për periudhën 23.11.2025-31.12.2025, duke mos e finalizuar procesin e vlerësimit në një formular të vetëm.

Në këtë rast, sjellim në vëmendje të zyrtarëve vlerësues dhe njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore se, në përputhje me pikën 6 dhe 7, të kreut III, “Detyrat e nëpunësve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë”, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, ku parashikohet se:

(pika 6) “... Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga ai pozicion apo ndodhen në pamundësi të vazhdimit të detyrës, ata janë të detyruar të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit për periudhën gjatë së cilës kanë ushtruar detyrën.

(pika 7) Vlerësimi sipas pikës 6 të këtij kreu, merret si bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar”,

zyrtarët vlerësues kanë detyrimin ligjor të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit që mbikëqyrin në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike, për të gjithë periudhën e ushtrimit të këtij funksioni. Në rast se, një nga zyrtarët largohet apo ndodhet në pamundësi të vazhdimit të mëtejshëm të detyrës, ai ka detyrimin ligjor të bëjë vlerësimin për nëpunësit nën hierarkinë e tij, për periudhën gjatë së cilës ka ushtruar detyrën. Ky vlerësim do të shërbejë si bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar, i cili është një vlerësim i përmbledhur i suksesit të nëpunësit dhe duhet të përfshijë të gjithë periudhën e vlerësimit, duke përpiluar për këtë qëllim edhe një formular të vetëm vlerësimi të rezultateve në punë për punonjësin.

Më tej, zyrtari/zyrtarët që largohen gjatë periudhës së vlerësimit, duhet të dorëzojnë vlerësimin e pjesshëm pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila më pas duhet ta vendos atë, në dispozicion të zyrtarit i cili do të veprojë si zëvendësues i zyrtarit të larguar. Zyrtari që është në detyrë në fund të periudhës së vlerësimit, do të bëjë vlerësimin përfundimtar të nëpunësit për të gjithë periudhën 6 mujore të vlerësimit, duke marrë parasysh të gjitha vlerësimet e pjesshme.

Në rastin konkret, konstatohet se subjekti i ngarkuar prej ligjit, në rolin e Zyrtarit raportues dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në institucionin e Ministrisë së Drejtësisë, nuk e kanë finalizuar këtë proces vlerësimi, pasi rezulton të mos jetë hartuar dhe depozituar në dosjen e nëpunëses M. Hoxha, një formular i vetëm vlerësimi i rezultateve në punë, për periudhën 01.07.2025-31.12.2025, ku të pasqyrohen arritjet në punë të nëpunëses, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

Sa i takon përmbajtjes së të dy formularëve të vlerësimit, konstatohet se, në ndarjen “D” të formularit “Nënshkrimi” dhe në ndarjen “DH” të formularit “Rivlerësim nga zyrtari autorizues”, nuk janë vendosur datat e vlerësimit nga Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues dhe Zyrtari autorizues, në kundërshtim me kërkesat e kreut IV, “Formulari i vlerësimit”, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.

Vlerësojmë se, të gjithë zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit kanë detyrimin ligjor të plotësojnë të gjitha rubrikat e formularit, pasi secila prej tyre paraqet një rëndësi të veçantë gjatë realizimit të procesit, ç'ka dëshmon se vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin është bërë me objektivitet, duke vlerësuar cilësinë e punës së kryer dhe objektivave të arritura për periudhën e vlerësimit.

Referuar problematikës së evidentuar më sipër, sa i takon **mangësive** në plotësimin e formularit në rastin e vlerësimit të nëpunëses, njësia e burimeve njerëzore, duhet të kujdeset në vijim, që në momentin e dorëzimit të aktit të vlerësimit, të kontrollojë plotësimin e të gjithë elementeve të aktit dhe në rast se konstatohen parregullsi, ta kthejë atë për plotësim tek zyrtari vlerësues që i korrespondon problem që duhet rregulluar, i cili në përputhje me kërkesat e aktit nënligjor, që është Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të materializojë qëndrimin e tij me komentet dhe argumentet përkatëse.

Më pas, formulari duhet t'i vihet në dispozicion nëpunësit të vlerësuar për t'u njohur me të, si dhe për ta nënshkruar atë, duke respektuar gjithashtu kërkesat ligjore sa i takon afateve të ankimit.

Në këto rrethana, sjellim në vëmendje të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë se, vlerësimi i rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili i shërben verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Vlerësimi i performancës në punë ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil dhe shërben për të marrë vendime objektive edhe në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirim nga shërbimi civil, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Sa më sipër, gjatë hartimit të aktit të vlerësimit të punës, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, e për pasojë akti që ka finalizuar procesin e vlerësimit të punës, është një akt që ka dalë në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 109, e për këtë arsye duhet të anulohet dhe të përsëritet procesi nga zyrtarët vlerësues sipas nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; ligjit nr.44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 109 dhe nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Ministrisë së Drejtësisë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik – Dhjetor 2025, për nëpunësen Matilda Hoxha, të përsëritet nga zyrtarët vlerësues duke u kujdesur që të plotësohen të gjitha rubrikat e formularit të vlerësimit dhe të materializohet veprimi administrativ, në një akt të vetëm, për periudhën përkatëse.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **15** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Ministria e Drejtësisë, si dhe nëpunësja Matilda Hoxha.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)